




Tofana Xano
Aurela Saliaj
Besa Monopoli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr. 2457 / Prot.
3

Vlorë më, 28.10.2024

VENDIM

Nr. 22, datë 24.10.2024

**PËR
MIRATIMIN E SKEDËS INFORMUESE PËR PJESËMARRJEN NË AKTIVITETE
KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE PËR STAFIN
AKADEMIK/JOAKADEMIK**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe Urdhërit Nr.44, dt.21.05.2018 të Rektorit mbi "Përcaktimin e rregullave për procesin e mësimdhënies në një institucion të arsimit të lartë jashtë vendit", referuar propozimit të Rektorit për hartimin dhe dorëzimin e një raporti pune me shkrim për pjesëmarrje në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, Rektorati në mbledhjen e datës, 11.10.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë procedurën e raportimit pas pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare si vijon:
 - a. Personeli akademik / joakademik pasi marrjes së lejes dhe kthimit nga aktiviteti raporton në Departament / Sektor.
 - b. Dorëzon tek Drejtuesi i Njesisë Bazë / Përgjegjësi i Sektorit një raport pune me shkrim, i cili protokollohet sipas një skede të përcaktuar, në fraksion të lejes së kërkuar.
 - c. Në mbledhjen e radhës së njesisë / sektorit, drejtuesi paraqet për diskutim konstatimet dhe rekomandimet e dhëna në raport.
 - d. Në bazë të kërkesës së personelit, raportimi mund të bëhet edhe me prezantim përpara njesisë.
2. Të miratojë skedën informuese mbi pjesëmarrjen në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare të personelit akademik/joakademik sipas materialit bashkëlidhur.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Njësitë Kryesore dhe Rektorati i UV.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


REKTOR

PROF. DR. AURELA SALIAJ

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

4. Konstatime

Cilat janë mësimet dhe njohuritë që keni fituar gjatë aktivitetit?
Si mund të aplikohen këto mësimet dhe njohuri në Universitetin e Vlorës?

5. Rekomandime për Përmirësim

Rekomandimi 1:
Rekomandimi 2:
Rekomandimi 3:

6. Komentet dhe Sugjerimet shtesë:

Ju lutemi përdorni këtë hapësirë për të shtuar çdo informacion shtesë ose koment që mund të ndihmojë në përmirësimin e proceseve dhe praktikave në UV.
Foto